


GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Nebojsa Peric nga Graçanica, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag. 1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73,74,195,199 dhe nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZK 23/79, me datë 12.10.2012 merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Nebojsa Miodrag Peric, i lindur më 14.09.1966 në Prishtinë, tam-jeton në Graçanicë, me profesion ekonomist, deputet në Kuvendin Komunal Graçanicë, me shkollim të lartë, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,



Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të deputetit të Kuvednit të Komunës së Graçanicës, nuk e ka bërë deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, brenda afatit ligjor deri më 31.03.2012,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 të ndëshkuar me nenin 17 parag.1.1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet dënim,

Q O R T I M I

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej 10 Euro në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtuesit të kërkesës dhe të pandehurit.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate Kërkesën 01-2351/2012 me datë 20.07.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Në bazë të kërkesës së parashtuar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se me datë 30.09.2012 ia kishte dorëzuar personalisht zyrtares kontaktuese formularin e plotësuar për deklarimin e pasurisë me qëllim që e njëjta t'a dorëzojë në AKK, por zyrtarja kontaktuese ndonëse të gjithë formularët e tubuar nga zyrtarët e lartë komunal dhe deputetët tjerë i kishte dorëzuar të nesërmen në AKK, vetëm formularin e deputetit Nebojsa Peric, pa qëllim e kishte harruar në zyrë, pa qenë në dijeni fare për këtë fakt, për çka prezantoi në gjykatë edhe shkresën njoftuese adresuar nga zyrtarja kontaktuese për AKK të datës 17.08.2012 si dhe Vërtetimin e AKK për konfirmim të pranimin të deklarimit të pasurisë për deputetin Peric gjithashtu të datës 17.08.2012.

Për vërtetim të plotë dhe të drejtë faktike gjyqtarja dëgjoi edhe zyrtaren kontaktuese të Komunës së Graçanicës, në cilësi të dëshmitares, e cila deklaroi vërtetësinë e shkresës së datës 17.08.2012 dhe në vazhdim e njëjta me përgjegjësi morale dhe materiale pranon se ka bërë lëshim dhe se pa asnjë qëllim për shkak të mbingarkesës gjatë grumbullimit të formularëve nga gjithë deputetët dhe zyrtarët tjerë të lartë komunal, rastësisht ka harruar në zyrë të saj formularin e plotësuar të deputetit Nebojsa Peric pa qenë fare në dijeni për këtë lëshim deri në momentin kur e njëjta është niftuar nga zyrtari i AKK për ngritje të procedurës kundërvajtëse kundër deputetit Peric. Në vazhdim dëshmitarja theksoi se formularët për deputet i kishte dorëzuar të njëjtën ditë me datë 30.03.2012 rreth

03-3802/12/02
fug

orës 14:30 por për shkak të tollovisë gjatë dorëzimit të formularëve, vërtetimet për konfirmim dorëzimi për secilin deputet i kishte marrë me datë 17.08.2012 kur edhe e kishte dorëzuar formularin për deputetin Peric, por normalisht me datën e dorëzimit.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, të dëshmitarit, provës materiale dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, administrimi i secilës veç e veç dhe të gjitha së bashku, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, meqë i njëjti nuk arriti të dëshmojë me shkrim se vërtetë me datë 30.03.2012 ia kishte dorëzuar formularin zyrtares kontaktuese, se i njëjti duke qenë në dijeni për seriozitetin dhe peshën e mosdeklarimit të pasurisë, është dashur të mbajë evidencë për dorëzim-pranim të formularit midis tij dhe zyrtares kontaktuese dhe për shkak të sensitivitetit të çështjes është dashur të interesohet edhe ditën e parë të ardhshme të punës kur ende ka pasur kohë për dorëzim deklarimi, andaj gjyqtarja konsideroi se i njëjti në fund nuk e ka përmbushur obligimin ligjor, e shpalli përgjegjës për kundërvajtjen e kryer dhe në aplikim të nenit 10 të LK i shqiptoi dënim qortimi si dhe paushallin gjyqësor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe sipas peshës së kundërvajtjes e shkallës së përgjegjësisë së pandehurit, e duke vlerësuar edhe personalitetin e të njëjtit, faktin se deklarimi i sivjetëm ka qenë i pari për deputetët komunal që paksa arsyeton neglizhencën e të pandehurit, e poashtu edhe besimin e tij ndaj zyrtares kontaktuese, të gjitha këto si rrethana veçanërisht lehtësuese, e dënoi me dënim qortimi të precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.29055/2012, datë 12.10.2012

Gjyqtarja
Suzana Çerkini

KËSHILLA JURIDIKE Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.

